




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-1447/15
Dep. 03	Br Prot. 01-1447/15
Nr. llog. 03	Data 28.05.2015
Nr. pages	Date 28.05.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.05.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-1150-15 për znj. Besa Bytyqi – Anëtare e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK)ës, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-1150-15, për Zyrtaren e lartë, znj. Besa Bytyqi – Anëtare e Bordit Drejtues të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), dhe njëkohësisht udhëheqëse e divizionit të Zyrës për informim në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Bytyqi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo ka qenë në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast, është njoftuar me pretendimet që kanë ardhë nga një palë e tretë, për situatë të dyshuar për konfliktit interesi në ushtrimin e funksionit publik, duke qenë se znj. Bytyqi ushtron funksionin e Anëtarit të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dhe njëkohësisht, sipas pretendimeve është edhe Drejtoreshë e Zyrës për media dhe komunikim në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Nga takimin me zyrtaren e lartë znj. Bytyqi, jemi njoftuar se ajo ka vetëm një funksion që e radhitë ate në mesin e zyrtarëve të lartë publik. Konkretisht pozita e saj Anëtare e Bordit të RTK-së.

Ndërsa në MASHT ajo nuk është Drejtoreshë e zyrës për media dhe komunikim (siç pretendohet në informacion), por është udhëheqëse e divizionit për Komunikim Publik.

Këtë fakt znj.Bytyqi e ka dëshmuar edhe me shkrim në sqarimin që i ka dërguar Agjencisë kundër Korrupsion (DPK-DPKI-03-02-1413-15) në të cilin, pos tjerash, është bashkangjitur edhe një shkresë zyrtare; “Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit” i cili është i bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr.01/161 dhe shkresës së DASHC/MAP 04/157102/ZSP/3851 dhe Vendimit të MASHT-it, nr.2.208, e me të cilin i është harmonizuar edhe koeficienti i pagës.

Kjo sepse paraprakisht, siç ka sqaruar znj.Bytyqi në shkresën e saj, me Vendim nr.2/1057 të datës 07.05.2012, MASHT i kishte ngritur asaj pozitën nga udhëheqësi i divizionit në Drejtor duke u bazuar në Rregulloren Qeveritare për Komunikim me Publikun nr.03/2011, e cila ndër të tjera, siç shkruhet në shkresë njoftuese, ka paraparë që udhëheqësit e Zyrave të Komunikimi të kenë pozitën Drejtor.

Pikërisht kjo rrethanë, znj.Besa Bytyqi pastaj e ka futë edhe në mesin e zyrtarëve të lartë publik dhe bashkë me te edhe obligimi ligjor i saj ndaj Agjencisë kundër Korrupsion për të bërë Deklarimin e pasurisë.

Por, duke qenë se tanimë kjo rrethanë ka ndryshuar dhe znj.Bytyqi ushtron vetëm një funksion që me ligj hynë në mesin e zyrtarëve të lartë publik (Anëtare e Bordit në RTK), ushtrimi i pozitës udhëheqëse e divizionit për informim në MASHT nuk e sjell atë ndesh me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, sepse nuk ka konflikt faktik të interesit.

Mund eventualisht të ketë ndonjë situatë të konflikti të interesit “rast pas rasti”, por në rrethana të tilla, znj.Bytyqi është e njoftuar me obligimin e saj ligjor për deklaram të këtyre rrethanave dhe për tërheqje nga çfarëdo lloj vendimmarrje që mund të krijoj situatë të konflikti të interesit, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit (Nr.04/L-051), neni 13, paragrafi 1,2,3.

Po ashtu, ushtrimi i funksionit të Anëtares së Bordit të RTK-së dhe udhëheqëse e divizionit për Komunikim me publikun në MASHT nuk bie ndesh as me Ligjin për RTK-në, sepse një ndalesë e tillë nuk parashihet as te dispozitat që e flasin për pamundësinë për të qenë Anëtar i Bordit të RTK-së. Kjo është e rregulluar si në vijim;

Neni 27 (Ligji për RTK-në)

Pamundësia për të qenë anëtarë i Bordit

1. Anëtar i Bordit të RTK-së nuk mund të jenë:

1.1. anëtarët e familjes së ngushtë të stafit menaxhues

1.2. ish punonjësit të punësuar në RTK në dy (2) vitet e fundit;

1.3. personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionaret publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;

1.4. është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;

1.5. është anëtar i organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike;

1.6. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;

1.7. të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;

1.8. pronarët apo bashkëpronarët e mediave transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;

1.9. është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

2. Anëtari i Bordit ose anëtari i ngushtë i familjes së tij nuk guxon të ushtroj veprimtari afariste me institucionin publik të RTK-së.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

